Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

03.04.2023, Prishtinë,
Ref:02.02.2023\1348-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Zamira Rexhepaj Mehmetaj kundër Indeksonline

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 28 mars 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Zamira Rexhepaj Mehmetaj kundër Indeksonline lidhur me publikimin e shkrimit me titull "Kujdes nga vajzat e Deçanit, dy femra e rrahin fort një mashkull", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa është e patrajtueshme.

A R S Y E T I M I

Media ka publikuar një lajm me titull "Kujdes nga vajzat e Deçanit, dy femra e rrahin fort një mashkull", me pretendimin se shkrimi është tendencioz, por pa përmendur se cili kapitull i Kodit të Mediave të Shkruara është shkelur.

Lajmi është shkruar në gazetë online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës, KMShK gjen se ankesa është e pa trajtueshme.

Media ka raportuar mbi një incident që ka ndodhur në të vërtetë, pasi që është përshkruar raporti 24 orësh i Policisë së Kosovës. Në anën tjetër ankuesja nuk e ka sqaruar se çfarë e sheh si tendencioze tek shkrimi, veç faktit që media ka përmendur që kryes të dhunës janë gratë e jo burrat, siç ndodh zakonisht.

Andaj, KMShK vendos që ankesa është e patrajtueshme.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës